

FJALA E DEPUTETIT BLENDI KLOSI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Kolegë, jemi regjistruar shumë për të folur për një projektligj, i cili ka rëndësinë e një projekti shumë të rëndësishëm për Shqipërinë. Ndoshta jo të gjithë ne duhet që këtë projekt ta diskutojmë politikisht, sepse realisht është një projekt që nuk i takon kësaj maxhorance, nuk u takon qytetarëve që na kanë votuar ne, por është një projekt që i takon Shqipërisë së gjeneratës së re, është projekti që i takon Shqipërisë së shekullit të ri.

Në përgatitjet e një takimi elektoral me qytetarët e Vlorës ne patëm disa kronika dhe një nga kronikat ishte shumë interesante, do të doja të ishin këtu edhe kolegët e opozitës dhe t'jua vija, sipas variantit tuaj, celularin në mikrofon, por nuk dua ta bëj këtë, dhe vetëm para 5 vjetësh kronika thoshte: "Partia Demokratike e qytetit të Vlorës organizohet masivisht (aty ishin vetëm 10-15 veta, por që për ju është mbledhje masive) për projektin e Lungomares" dhe një nga drejtuesit e lartë të Partisë Demokratike, vetëm 4-5 vjet më parë, që sot është në sallë, deklaronte se projekti i Lungomares është një projekt korruptiv i Edi Ramës për të grabitur vijën bregdetare, për t'ia dhënë vijën e detit oligarkëve dhe për Vlorën është fatkeqësi e madhe që Edi Rama është Kryeministër dhe deputet i Vlorës, por sot, pas vetëm 4 vjetësh nga kjo protestë madhështore e Partisë Demokratike, në Lungomare ne morëm disa mendime të qytetarëve dhe vetëm në 5 vjet në atë zonë vlera e pronës u rrit nga 4 deri në 5 herë, një metër katror shitej me 500-600, sot shitet me 2000- 2500 euro metri.

Këtë mund ta vërtetojnë edhe deputetet e Vlorës. Një nga personazhet më të njohur të Lungomares tha që para 4-5 vjetësh në këtë Lungomare ka pasur vetëm 5 lokale, 2 peshku dhe 3 nga ata me mish në hell, ndërsa sot ka pa fund lokale dhe komunitet biznesi, i cili jeton, punon dhe prodhon ekonominë në Lungomare. Kjo është fiks edhe ajo që do të ndodhë me disa kolegët tanë, të cilët, pas disa viteve, do të diskutojnë për fazat e tjera të projektit për portin e Durrësit. Kjo është mënyra më e mirë për ne për të bërë politikë dhe është mënyra më e mirë për të evidentuar sesi, qorrazi, në asnjë rast nuk përpiqeni të diskutoni teknikisht gjërat.

Sa mirë do të ishte që ky projekt të diskutohej nga ekspertët tuaj, të vinin këtu dhe të bënin edhe komente, por që në fund fare të kishte një vulë të përbashkët, pasi është shumë e rëndësishme që jo vetëm ai investitor, por të gjithë investitorët në Shqipëri të kenë besim se politika i ndihmon njerëzit, e

ndihmon biznesin dhe e ndihmon zhvillimin. Meqenëse jemi te politika, Edi Rama e tha sot, por e ka thënë shpesh: “Ne themi ato që bëjmë dhe bëjmë ato që themi”. Durrësi nuk është një betejë e re elektorale, apo një fushëbetejë e re politike, sepse ne jemi përballur disa herë në Durrës. Të nderuar kolegë, Kam një gazetë elektorale të vitit 2015 të Partisë Socialiste dhe kandidati i Partisë Socialiste, së bashku me Edi Ramën, në vitin 2015 deklarojnë: “Marina do të kthehet për shërbime portuale; porti i jahteve Marina hapësirë tregtare rekreative; porti i jahteve Marina është promotori i zhvillimit”.

Në politikat tona të zhvillimit “Marina” shihet tashmë si një xhevahir i çmuar i zhvillimit vendor dhe rajonal, e konceptuar në harmoni të plotë me mjedisin rrethues, projekti e konsideron “Marinën” jo si vend i ruajtjes fizike të anijeve, por si pjesë të turizmit ndërkombëtar e të tjerë. Në vitin 2015 kemi premtuar këtë që po votojmë sot. E thamë, e bëmë. Sa mirë që e hëngre edhe ti, sepse ti e ha përherë! Kam këtu atë që thoshte kandidatja juaj në vitin 2015: “Nga ana tjetër, ai është trajtuar gjithmonë si një port industrial. Porti nuk është trajtuar si një port turistik, gjë që do të bënte pjesë në menaxhimin e këtij qyteti. Kjo është një situatë që duhet të ndryshojë domosdoshmërisht”. Këtë e thotë kandidatja juaj.

Po ashtu, ajo shprehet se, nëse do të fitojë, vetëm në dy vjet do ta kalojë portin në një destinacion të madh turistik. Pra, kjo është e vërteta. Të gjithë që duam të ndryshojmë atë gjë, sepse unë nuk po them se ka dashur të gënjejë, kanë dashur të thonë të vërtetën. Porti i Durrësit është aseti më i madh turistik i Shqipërisë. Porti i Durrësit është aseti më i madh i zhvillimit 3-mijëvjeçar të atij qyteti. Kjo është e vërteta. Ama para 3 mijë vjetësh sillte ato që sillte; para 100 vjetëve, siç e tha atë edhe kolegu Shehu, me shumë respekt, sillte krom apo nxirrte krom nga Shqipëria, sepse atë kishim; sot do të sjellim më të mirën dhe më e mira është turizmi, me e mira janë investimet në hoteleri, më e mira janë asetet turistike. Shqipëria duhet të krijojë ekonominë e detit, Shqipëria duhet të krijojë ekonominë blu.

Si do të krijohet kjo ekonomi pa marinë, me moratoriumin e skafeve që kishit ju për tetë vjet?! Në kohën tuaj deti ishte armik, nga deti vinte armiku apo shkonte armiku, deti nuk ekzistonte për ju si fuqi ekonomike! Tani, ne nuk mund të ndjekim gjithë kohë ato që thoni ju. Për Durrësin do të ndërtohet një port i ri, me investim jashtëzakonisht të pëlqyer, të kërkuar, për të cilin ne jemi lutur dhe kemi tre vjet e gjysmë që negociojmë, derisa sot kemi një projekt, i cili shpreh zhvillimin e një qyteti. Para pak vitesh, vetëm 3-4 vjet më parë, në këtë Kuvend kemi miratuar projektligjin “Për miratimin e statusit special dhe ndihmën për hotelet me pesë dhe katër yje”. Ishin të njëjtët deputetë që e kundërshtuan, thanë se po ia jepnim oligarkëve dhe çfarë nuk do të bëhet në Shqipëri, do të vijnë paratë e pista e të tjerë.

Tre janë hotelet që e kanë përfituar këtë status: “Melia hotel” në Durrës, “MK hotel” në aeroportin e Rinasit, dhe “Armada “ hotel në Durrës. E kemi thënë atëherë, po e themi edhe tani, ky ka qenë treni që tërhiqte të gjitha hotelet e tjera: “Fuqia e pesë yjeve”. Pra, ato hotele që marrin këtë status vijnë të parët. Sot, në një intervistë të CEO-s së “Melias” në Shqipëri u tha se ka shtatë projekte në vetëm tre vjet. A e mendoni para 4-5 vjetëve që Shqipëria do të ishte një destinacion i hoteleve me pesë yje? Si mund të silllet zhvillimi nëse nuk kemi investitorë të tillë, që e çojnë përpara gjënë, e rritin një shkallë më lart ekonominë e këtij vendi? Si do të kemi mundësi të ecim para nëse nuk bëjmë kaq shumë investime në hoteleri? Ne e kemi kthyer Shqipëri në destinacion turistik.

Po ju jap edhe një premtim tjetër, që e mbajtëm: Shqipëria kampione e Ballkanit në turizëm nën drejtim e kësaj qeveria. Si do të bëhej? Si do të kemi ne mundësi të konkurrojmë me Greqinë, me Italinë, me Malin e Zi, me Kroacinë, me Turqinë, me ujqërit e turizmit në rajon, pa pasur investime, pa pasur mundësi zhvillimi, pa pasur hotele me katër apo pesë yje, pa pasur infrastrukturë portuale, infrastrukturën e nevojshme, pa pasur porte apo aeroporte? Sot Shqipëria është një kantier falë këtyre politikave.

Prandaj, të nderuar kolegë, pa dashur të bëj shumë politikë, e mora fjalën sepse edhe unë doja të shprehja mbështetjen time për këtë projekt, pasi vitet do të na gjykojnë për shumë gjëra, por ne nuk mund të na gjykojnë për të mirën e qytetarëve shqiptarë. Ne duhet ta mbështesim këtë projektligj dhe të gjithë duhet të jemi në mbështetje të tij, pa dyshim me kritika, me komente, me analiza, pa dyshim edhe me vërejtje, nuk ka asnjë gjë të keqe, por jo duke e kundërshtuar projektin, idenë e zhvillimit, përparësisë, të cilën, siç jua thashë, e kërkon politika e të dyja krahëve për qytetarët shqiptarë.

Së fundi, dua të them edhe diçka tjetër, ne si bektashinj duhet të shkojmë në malin e shenjtë të Tomorit, miqtë tanë katolikë të shkojnë në Kishën e Laçit, ortodoksët dhe myslimanët në vendet e tyre të shenjta dhe të gjithë së bashku të lutemi që ky projekt të ndodhë, sepse është shumë i nevojshëm. Perëndia le t’i dëgjojë gjithmonë e më shumë lutjet e njerëzve që duan të mirën e këtij vendi. Këta njerëz nuk duhet t’ju dëgjojnë ju që të mblidhen për të protestuar në datën 6 dhjetor. Për herë të parë në historinë e demokracisë shqiptare një forcë politike do të dalë kundër BE-së; për herë të parë, nuk ka rëndësi fare sa njerëz do të jenë, si do të jenë dhe si do të organizohen, një forcë politike do të dalë kundër liderëve të BE-së në Shqipëri dhe kjo është shumë negative.